



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTRI

Nr. 2571/1 prot.

Tiranë, më 26.3. 2020

URDHËR

Nr. 141, date 26.3.2020

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT DHE ORGANIZIMIT TË
KOMISIONIT TË REGJISTRIMIT TË PRODUKTEVE PLEHËRUESE**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 9 të ligjit 17/2020, “Për produktet plehëruese”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores së Funkzionimit dhe Organizimit të Komisionit të Produkteve Plehëruese, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhëri.
2. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtorja e Përgjithshme Rregulatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, Drejtorja e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTRI

Bledar Çuçi

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E
KOMISIONIT TË RREGJISTRIMIT TË PRODUKTEVE PLEHËRUESE

KREU I

“DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Rregjistrimit të Produkteve Plehëruese për aplikimin, shqyrtimin, miratimin dhe lëshimin e Çertifikatës së Rregjistrimit dhe etiketës, dhe për çështje të tjera të lidhura me produktet plehëruese.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptimin e kësaj rregulloreje:

- a) “Komisioni” është Komisioni i Rregjistrimit të Produkteve Plehëruese.
- b) “Ligji nr.17/2020 ” është Ligji nr.17/2020 “Për produktet plehëruese”

Përkufizimet e Ligjit nr.17/2020 kanë të njëjtin kuptim në këtë rregullore.

Neni 3

Baza ligjore

Komisioni i Rregjistrimit të Produkteve Plehëruese funksionon dhe ushtron aktivitetin e tij në përputhje me Kushtetutën, Ligjin nr.17/2020, Kodin e Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, Ligjin nr.8480 datë 27.05.1999 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Ligjin nr.9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, dhe aktet nënligjore përkatëse të miratuara në bazë të tyre.

Neni 4

Parimet e veprimtarisë

Në veprimtarinë e tij Komisioni respekton parimet e:

- a) Ligjshmërisë.
- b) Barazisë dhe mosdiskriminimit.
- c) Shqyrtimit brenda afateve.
- d) Transparencës.
- e) Mbrojtjen e të dhënave personale dhe sekretit tregtar.
- f) Parimit të ekonomisë, efijencës dhe efektivitetit.
- g) Parimit të llogaridhënies.

KREU II

ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA

Neni 5

Organizimi

1. Komisioni është organ kolegjal, i përhershëm, që ushtron aktivitetin e tij në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

2. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë:

- a) zëvendësministri, i cili kryeson komisionin;
- b) dy përfaqësues nga SPPP-ja në ministri, i caktuar me urdhër të ministrit;
- c) një përfaqësues nga laboratorit i referencës, i caktuar me urdhër të ministrit;
- ç) një përfaqësues nga Agjencitë Përgjegjëse për Këshillimin Bujqësor;
- d) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mjedisin;
- dh) një përfaqësues nga shoqatat e fermerëve.

3. Sekretar i komisionit të regjistrimit të produkteve plehëruese është specialisti që mbulon produktet plehëruese pranë SPPP-së në ministri. Ministri në mënyrë të përkohshme cakton në këtë detyrë një nëpunës civil të ministrisë.

4. Sekretari administron aplikimet, kërkesat dhe dokumentacionin, mban procesverbalin e mbledhjes, harton projektvendimet, vendimet dhe kryen çdo detyrë tjetër për mbarëvajtjen e punës, si dhe kryen detyrat e caktuara nga kryetari. Sekretari i komisionit përditëson në faqen e ministrisë formularin dhe dokumentacionin që duhet të paraqesë çdo subjekt aplikues dhe harton dhe publikon udhëzues.

5. Kryetari dhe anëtari i komisionit lirohet nga detyra kur:

- a) nuk është në marrëdhënie pune me institucionin përkatës,
- b) nuk ushtron detyrën për 3 mbledhje rresht,
- c) dënohet me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale,
- d) për arsye të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 6

Kryetari dhe anëtarët e komisionit

1. Kryetari drejton dhe organizon veprimtarinë e komisionit, nënshkruan aktet e miratuara. Kryetari në veprimtarinë e tij asistohet nga sekretari i komisionit.
2. Kryetari delegon kryerjen e detyrave të veçanta që ligji nuk i ngarkon një subjekti të caktuar.
3. Anëtarët e komisionit marrin pjesë rregullisht në mbledhje. Anëtarët kanë të drejtë që para mbledhjes të njihen me rendin e ditës, dokumentacionin, dhe me projektvendimet.

Neni 7

Struktura përgjegjëse për produktet plehëruese dhe personeli ndihmës

1. SPPP zhvillon proceduarat që lidhen me regjistrimin e produkteve plehëruese, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe akteve të brendshme të ministrisë, ndjek e monitoron aktivitetin e produkteve plehëruese në nivel qendror dhe rajonal, në zbatim të këtij ligji.
2. Personeli i ministrisë kyen çdo detyrë ose jep çdo informacion të kërkuar nga kryetari i komisionit ose me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë.

Neni 8

Rendi i ditës

Mbledhja e Komisionit zhvillohet në bazë të një rendi dite të përcaktuar.

Kryetari i Komisionit vendos për rendin e ditës, në bashkëpunim me sekretarin dhe SPPP.

Në rendin e ditës përfshihen të gjitha kërkesat duke respektuar radhën e aplikimeve online të kërkesave. Në rast kur ka kërkesa në formë shkresore ato futen në radhë sipas datës së paraqitjes në raport me radhën e aplikimeve online.

Rendi i ditës ndryshon me shumicë të thjeshtë, me kërkesë të kryetarit ose një anëtarë të komisionit. Kërkesat për vendimarrje që nuk lidhen me aplikime shqyrton gjithmonë në fund të mbledhjes.

Neni 9

Mbledhja dhe votimi

1. Kryetari i Komisionit, ose sekretari me porosi të kryetarit, njofton anëtarët dhe subjektet e tjera të përcaktuara nga kryetari, në rrugë elektronike, për thirrjen e mbledhjes së Komisionit.
2. Njoftimi për mbledhje përmban rendin e ditës dhe dokumentacionin shoqërues.
2. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme vetëm nëse në të janë të pranishëm shumica e thjeshtë e anëtarë, një prej të cilëve duhet të jetë kryetari.
3. Komisioni vendos mbi bazë dokumentesh me 2/3 e anëtarëve të pranishëm. Anëtarët e Komisionit nuk mund të abstenojnë. Votimi bëhet i hapur, anëtarët votojnë duke filluar nga anëtarë më i ri në moshë. Kryetari voton i fundit.
Në rast votash të barabarta, vota e kryetarit përcaktuese.
4. Anëtarët e Komisionit që kanë pengesë ligjore, nuk duhet të jenë të pranishëm gjatë shqyrtimit, diskutimit dhe votimit të çështjes ku kanë pengesë ligjore.
5. Në mbledhjet e Komisionit mund të ftohen të marrin pjesë punonjës të ministrisë ose të institucioneve të varësisë ose ekspertë të fushave të caktuara, pa të drejtë vote.
6. Gjatë zhvillimit të mbledhjes respektohen, por pa u kufizuar në to, rregullat e mëposhtme:
 - a) Respektimi i orarit të caktuar për zhvillimin e mbledhjes nga anëtarët;
 - b) Respektimi i rendit të ditës gjatë zhvillimit të mbledhjes;
 - c) Respektimi i kohës në dispozicion të anëtarëve pjesëmarrës për të parashtruar qëndrimin e tyre të ndryshëm, nëse ka, e cila përcaktohet nga kryetari.
- ç) Çdo veprim tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e mbledhjes.

Neni 10

Vendimet e Komisionit

1. Komisioni shqyrton në mënyrë të plotë aplikimin mbi :

- a) etiketën përfundimtare të produktit plehërues, bazuar në etiketën e paraqitur nga aplikanti;
- b) regjistrimin e produkteve plehëruese në procedurë regjistrimi;
- c) reregjistrimin e produkteve plehëruese, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 13, të ligjit;
- d) çregjistrimin e produkteve plehëruese, sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 13, të ligjit;
- e) modifikimin e dokumentit të regjistrimit të produktit plehërues, sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 13, të ligjit.

2. Komisioni, pas shqyrtimit të kërkesës vendos:

- a) Miratimin e rregjistrimit dhe etiketës përfundimtare; rirregjistrimin; çregjistrimin e produkteve plehëruese; modifikimin e dokumentit të regjistrimit të produktit plehërues.
- b) refuzimin e kërkesës,
- c) kthimin e kërkesës për plotësim dokumentacioni,
- d) kalimin e marrjes në shqyrtim të kërkesës në mbledhjen e radhës dhe kryerjen e veprimeve të caktuara

3. Vendimi, Çertifikata e Rregjistrimit dhe Etiketa, nënshkruhen nga Kryetari dhe sekretari i komisionit, ndërsa procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari, anëtarët e komisionit dhe sekretari.

4. Kopje të vendimit, Çertifikata e Rregjistrimit dhe Etiketa, procesverbalit dhe dokumentacioni të paraqitur depozitohen në arkivën e ministrisë, brenda 10 ditë pune nga data e dhënies së vendimit.

5. Sekretari i Komisionit, për qëllime statistikore, mban një rregjistër në të cilin shënohen :

- a) Të dhënat e aplikuesit dhe data e aplikimit,
- b) dispozitivi për secilin aplikimin,
- c) prodhuesin,
- d) importuesin.

6. Sekretari jep infomacion të përditësuar në mënyrë elektronike, për zëvendës ministrin përgjegjës për bujqësinë dhe sekretarin e përgjithshëm të ministries në lidhje me produktet plehëruese të rregjistruara.

Neni 11

Afatet e vlefshmërisë së rregjistrimit të produkteve plehëruese

1. Afati I vlefshmërisë së rregjistrimit të produkteve plehëruese është si vijon:

- a) produktet plehëruese inorganike, me afat 4 vjeçar
- b) produktet plehëruese organike, me afat 4 vjeçar
- c) produktet plehëruese organo-minerare, me afat 4 vjeçar
- ç) produktet plehëruese bazuar në elemente ushqyese dytësore, me afat 5 vjeçar
- d) produktet plehëruese bazuar në mikroelemente, me afat 5 vjeçar
- dh) produktet plehëruese me veprim specifik (frenuesit, biostimulantët e bimëve), me afat 7 vjeçar

- e) produktet plehëruese të veçanta, me afat 7 vjeçar
- ë) korrektuesit, me afat 7 vjeçar
- f) substratet e kultivimit (rritjes), me afat 5 vjeçar;
- g) përmirësuesit e tokës, me afat 7 vjeçar;
- gj) materialet organike të destinuara për prodhimin e produkteve plehëruese organo-minerare, me afat 5 vjeçar.

Neni 12

Afati dhe vendimarrja

1. Komisioni merr vendim në themel për rregjistrimin e produkteve plehëruese, për çdo aplikim/kërkesë brenda afatit 20 ditor nga data e aplikimit në mënyrë të plotë që përfshin dhe paraqitjen e mostrës.
2. Komisioni merr vendime të tjera sipas afateve të parashikuara në ligj ose akte nënligjore.
3. Komisioni, në kryerjen e veprimeve procedurale vendos afate të arsyeshme për kryerjen e tyre por jo më të gjata se afatet ligjore
4. Komisioni mblidhet jo më pak se 1 herë në muaj.

Neni 13

Përrjashtimi

1. Kryetari ose anëtari i Komisionit nuk merr pjesë në vendimarrjen mbi një ankesë, kur ai gjendet në një nga rastet e konfliktit të interesit të parashikuar në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ose ka një pengesë ligjore.
2. Kur ekzistojnë shkaqet e mësipërme, anëtari i Komisionit njofton menjëherë kryetarin, i cili vendos mbi përrjashtimin. Përrjashtimi i kryetarit vendoset nga ministri.

Neni 14

Konfidencialiteti i të dhënave

1. Anëtarët e Komisionit, sekretari, anëtarët e SPPP dhe çdo person tjetër që në ushtrimin e detyrave të tyre në kuadër të një procedure vendimarrjeje për shqyrtimin e një kërkesë, ruajnë të dhënat personale dhe të dhënat që lidhen me sekrete tregtare.
2. Kryetari i Komisionit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, merr masat për ruajtjen e të dhënave personale dhe të dhënave që përbëjnë sekret shtetëror apo tregtar.
3. Publikimi i të dhënave si detyrim që rrjedh nga ligji ose aktet nënligjore bëhet për aq sa ligji ose aktet nënligjore detyron publikim të dhënash.